



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:068183
Datë: 09.10.2024
Numri i dokumentit: 06274314

Ac.nr.5129/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi - kryetar i kolegjit, Enes Mehmeti dhe Lumni Sallauka - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit H. G. nga P., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av. A. M. sipas autorizimit, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës-Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA), për shkak të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit, duke vendosur sipas ankesës së paditësit të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.1444/21 të datës 06.06.2022 në seancën e kolegjit të mbajtur më 09.10.2024 nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e paditësit H. G. nga P., ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.1444/21, i datës 06.06.2022, VËRTETOHET.

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.1444/21 të datës 06.06.2022 në pikën e parë të dispozitivit e ka aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit H. G. nga P. kundër të paditurës Komuna e Prishtinës-Drejtoria Komunale e Arsimit, si e bazuar. Në pikën e dytë të dispozitivit e ka detyruar të paditurën Komuna e Prishtinës-Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit, në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit t'ia kompensoj shumën prej 386.96 €, për 691 ditë pune për periudhën kohore prej datës 18.04.2017 deri me 08.04.2021, në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me detyrim. Në pikën e tretë të dispozitivit e ka detyruar të paditurën që shumën totale të gjykuar si në pikën II të këtij dispozitivi, paditësit H. G. t'ia paguaj më kamatë ligjore prej 8%, nga data 14.04.2021 (data e parashtrimit të padisë), e deri në pagesën definitive, në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me detyrim, ndërsa në pikën e katërt të dispozitivit e ka obliguar secilën palë që ti bart shpenzimet e veta të procedurës.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur paditësi për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, me propozim që Gjykata e Apelit

ta aprovojë ankesën si të bazuar, ta prish aktgjykimin e atakuar ta ndryshojë aktgjykimin e atakuar në lidhje me shpenzimet e procedurës.

E paditura nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizimit të të njëjtave, e në kuptim të nenit 194, 195 dhe 200 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e paditësit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi, H. G., përmes përfaqësuesit të autorizuar, me datë 14.04.2021, ka parashtruar padi kundër të paditurës, me objekt kontesti kompensim për shpenzimet e udhëtimit. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura në përgjigjen në padi, gjatë theksimeve në seancat gjyqësore si dhe në fjalën përfundimtare, e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, për arsye se kompensimet e tilla nuk janë paraparë me Ligjin e Punës, dhe si rezultat i kësaj e paditura Komuna e Prishtinës, gjatë përgatitjes së buxhetit nuk ka paraparë linjë të veçantë buxhetore për këto lloje të kompensimit. Andaj i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar. Lidhur me shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë, ka mbajtur seancë kryesore dhe pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.1444/21 të datës 06.06.2022 me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar

Në arsyetimin e këtij aktgjykimi, gjykata e shkallës së parë theksoi se në mes të palëve në mes të palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, nga vërtetimi nr.305, i datës 12.04.2021 të lëshuar nga Komuna e Prishtinës, gjykata ka konstatuar se paditësi ka vendbanimin në Prishtinë, më saktësisht Rruga “Jan Kukuzeli” nr.50, ndërsa me leximin e kuponave fiskal të datës 12.04.2021, gjykata ka konstatuar se paditësi ka kosto të transportit rrugor në vajtje ardhje në vendin e tij të punës në lartësi prej 0.80 cent në ditë. Po ashtu, mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësi, prej datës 18.04.2017, e deri më datë 08.04.2021 ka qenë prezent në vendin e tij të punës si mësimdhënës, çka u vërtetua edhe në bazë të Vërtetimit të lëshuar nga SHFMU “Ali Kelmendi” në Barilevë, në bazë të cilit Gjykata konstatoj se paditësi brenda kësaj periudhe kohore ka realizuar gjithsej 691 ditë pune. Andaj, gjykata e aprovoi kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar duke e mbështet vendimin e saj në nenin 35.5 të kësaj Kontrate Kolektive të Arsimit. Për sa i përket llogaritjes së kamatës ligjore vendimin e bazoi në nenin 382 të LMD-së, ndërsa për shpenzimet e procedurës vendimin e mbështeti në dispozitat e nenit 450, 452, e lidhur me nenin 463.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, pasi që pala paditëse në parashtrësën për precizimin e kërkesëpadisë nuk i kishte specifikuar shpenzimet secilën vec e vec dhe nuk kishte prezantuar prova për shpenzimet e bëra, kurse në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare

të dhënë më datën 26.05.2022, nuk i ka kërkuar fare shpenzimet e procedurës gjyqësore, andaj gjykata vendosi që secila palë të barte shpenzimet e veta procedurale.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat janë pretenduar nga pala ankuese.

Gjykata e Apelit vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Aktgjykimi i atakuar me ankesë është i rregullt në pikëpamje të strukturës dhe përmbajtjes duke përfaqësuar kështu një vendim i cili është koherent në pikëpamje logjike dhe juridike duke eliminuar çfarëdo kontradikte për ta kualifikuar si kundërtëhënës. Mënyra e zhvillimit të procedurës dhe e hartimit të vendimit nga gjykata e shkallës së parë kanë garantuar një proces të drejtë dhe të paanshëm duke u mbështetur për përfundimin e saj në themelin faktik dhe juridik të çështjes.

Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar si të pa bazuara pretendimet ankimore e të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit për shpenzimet e procedurës dhe si të tilla edhe janë refuzuar duke e vërtetuar aktgjykimi i shkallës së parë edhe në këtë pikë e kjo për faktin se bazuar në nenin 463, paragrafi 1 të LPK-së “ *Për pagimin e shpenzimeve procedurale gjykata vendosë vetëm me kërkesën e specifikuar të palës, pa bërë asnjë shqyrtim verbalisht lidhur me kërkesën* ” ndërsa neni 463, paragrafi 2 i LPK-së parasheh se “ *Pala ka për detyrë që në kërkesën e saj në mënyrë të specifikuar t’i tregoj shpenzimet për të cilat kërkon shpërblim, duke parashtruar prova për shpenzimet e bëra, po që se nuk ekzistojnë provat e tilla në dosjen e lëndës* ”, ndërsa përfaqësuesi i autorizuar i palës paditëse në parashtrësën për precizimin e kërkesëpadisë nuk i kishte specifikuar shpenzimet secilën veç e veç dhe nuk kishte prezantuar prova për shpenzimet e bëra, kurse në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare të dhënë më datën 26.05.2022, nuk i ka kërkuar fare shpenzimet e procedurës gjyqësore, të cilën ishte i obliguar bazuar në nenin 7 paragrafi 1 të LPK-së që parasheh se “ *Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla* ”.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave

Numri i lëndës: 2021:068183
Datë: 09.10.2024
Numri i dokumentit: 06274314

nga neni 194, 195 par. 1 pika d) të LPK-së, lidhur me neni 200 të LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.5129/2022, datë 09.10.2024

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari,
Ardian Ajvazi